

**PËRQASJE GJUHËSORE MIDIS SË FOLMES  
SË GUMENICËS SË VLORËS DHE TË FOLMEVE  
TË BREGUT TË DETIT**

Artan XHAFERAJ

Punim studimor

**Përmbajtje e shkurtër:** Në këtë punim do të përpiqemi të trajtojmë disa përfaqje gjuhësore midis së folmes së Gumenicës së Vlorës dhe të folmeve të Bregut të Detit. Synimi i këtij punimi është njohja e tipareve të përbashkëta dhe dallimet gjuhësore midis këtyre të folmeve, duke i krahasuar në disa raste edhe me shqipen standarde. Ritet, mitet, besimet dhe veçoritë gjuhësore të këtyre të folmeve lidhen ngushtë edhe me historinë e përbashkët të krahinave. Vëmendja përqendrohet tek veçoritë e përbashkëta në rrafshin fonetik dhe morfologjik. Afria midis këtyre të folmeve dëshmohet qartë përmes fakteve dhe dukurive gjuhësore, të cilat shpjegohen me rregullsitë e evolucionit të sistemit fonetik dhe të strukturës morfologjike të shqipes. Metoda e përdorur është ajo e analizës dhe e krahasimit. Për realizimin e kësaj trajtесе jemi mbështetur në studimin tonë për të folmen e Gumenicës dhe fshatrave përreth në Labërinë e Poshtme, si edhe në punimet e studiuesve shqiptarë për të folmet e Bregdetit.

**Fjalë çelësa:** E folme, tipare gjuhësore, dallime gjuhësore, shqipe standarde, rrafsh fonetik, rrafsh morfologjik

Gumenica ndodhet në anën jugperëndimore të rrethit të Vlorës, në Labërinë e Poshtme. Në regjistrin turk të Halil Inalçikut (1431-1432), Gumenica shënohet me 48 shtëpi dhe 2551 akçe, ndërsa sipas të dhënave të

Deferit të Regjistrimit Osman të Sanxhakut të Vlorës të muajit shkurt 1583, Gumenica është përfshirë në një territor të kufizuar me qendrën e fshatit, ku është sot dhe deri në kufi me fshatin Lapardha. Në këtë territor ishin shpërndarë 121 shtëpi të asaj kohe me 141 burra familjarë dhe 20 djem beqarë. Aty shënohet që pjesa e tokës truall deri tek Kaster *Vodica* sundohej me emrin e fshatit Gumenicë.


Sipas peshkopit të Mitropolisë së Beratit Anthim Aleksudhit (Anthimus Alexoudes), fshati Gumenicë ishte fshat i lirë dhe mbisundonte mbi fshatrat e tjera përreth.<sup>1</sup> Në Gumenicë ka pasur një manastir ortodoks ku qëndronte në mënyrë të përhershme kryetari i murgjve ortodoksë (igumeni). Ky manastir ka pasur nën vartësi krahinën që nga Drashovica e lart, duke përfshirë edhe fshatin Brataj, ndërsa vilajeti ka qenë në Kaninë. Mendojmë se tema burimore e toponimit të sotëm, Gumenicë, rrjedh prej gjuhës greke *ηγούμενος* [igúmenos] “kryemurg ortodoks”, e zgjeruar me prapashtesën sllave *-icë*, në kohën e dyndjeve sllave. Emërtimi i vendit mund të jetë kryer prej bullgarëve, sepse edhe ata e kanë marrë fjalën *игумен* “kryemurg” nga grekët. Si pjesë e Labërisë, ajo ka pasur lidhje të vazhdueshme me fshatrat përreth, si dhe me fshatrat e Bregut të Detit, veçanërisht me fshatrat e Bregdetit të Sipërm. Në shekullin XV Gumenica e Vlorës përmendet në dokumente të ndryshme si një nga fshatrat e krahinës së Himarës për pjesëmarrjen në kryengritjet antiosmane. Në shek. XV Himara përfshinte gjithë viset JP të Shqipërisë, trevën e sotme të Himarës, Bregun e Poshtëm (Borsh-Nivicë-Bubar), Lumin e Vlorës, Kurveleshin e Poshtëm dhe të Sipërm, trevën e Tepelenës dhe rrethet e sotme të Sarandës e të Delvinës, me gjithsej 50 fshatra.<sup>2</sup> Shtrirja gjeografike e Himarës ka ndryshuar historikisht. Gumenica ka qenë si kufi verior për krahinën e Himarës. Këtë e dëshmojnë edhe vargjet e një kënge të vjetër popullore të Labërisë, të krijuar në Himarë: *Që në Gumenicë e lartë,/ Himarë quhet çdo fshat/ gemë rigatë me fesat/ Osmënlliu me zanat/ Na ndau e mbemë pak.*<sup>3</sup> Një variant i kësaj kënge, mbledhur në Vuno, Qeparo e Himarë, ka të përba-shkëta dy vargjet e para, ndërsa në katër vargjet e fundit përcakton kufijtë e krahinës së Himarës: *Që në Gumenicë e lartë,/ Himarë quhet çdo fshat..../*

<sup>1</sup> Anthimus Alexoudes, *Σύντομος ιστορικὴ περιγραφή τεσλερασ μητροπόλεος Βελ-εγραδον...*, [Përshkrim i shkurtër historik i metropolisë së Beratit dhe i vendeve që janë nën vartësinë e saj shpirtërore] (përkthyer nga V. Nika), Kerkyra, 1868, f. 42.

<sup>2</sup> Mevlan Kabo, *Veçori gjeografike të trevës së Himarës*, në “Himara në shekuj” (Ribotim), Toena, Tiranë, 2006, f. 11.

<sup>3</sup> Fatos M. Rrapaj, *Këngë popullore të Labërisë*, Tiranë, 1991, f. 772.

*E nisim me Bregdenë,/ E shkojmë në Tepelenë,/ Vemi kuçi me Delvinë,/ Ndë Dragji e gjer Kaninë.*<sup>4</sup>



Gumenica e Vlorës si dhe fshatrat e tjerë të njësisë administrative Kotë [sot pjesë e bashkisë së Selenicës të prefekturës së Vlorës]: Mazhar, Lapardha, Vodice, Drashovicë, Mavrovë, Shkallë-Mavrovë, Hysoverdh e Vajzë, të cilat shtrihen në pjesën e mesme të luginës së Shushicës, kanë shumë karakteristika të përbashkëta me Bregun e Detit, veçanërisht me Bregdetin e Sipërm, që përfaqësohet nga krahina e sotme e Himarës. Banorët e fshatrave të Bregdetit të Sipërm janë të ardhur më shumë nga Kurvelesi dhe krahina e Korçës, por nuk mungojnë vëllazëritë e ardhura nga veriu i Shqipërisë, pikërisht nga Kruja, Mirdita, Dukagjini e Kelmendi<sup>5</sup>. Në fund të shek. XVII dhe në fillim të shek. XVIII në Kurvelesh u vendosën shumë banorë nga bregdeti i Himarës, për t'i shpëtuar sundimit osman<sup>6</sup>. Lidhjet shumë të ngushta dhe vëllazërore midis Bregut të Detit dhe pjesës

<sup>4</sup> Fane Veizi, *Bregu i Detit në këngë*, Arbri, Tiranë, 1998, f. 3.

<sup>5</sup> Natasha Sotiri, *E folmja e Himarës*, në "Himara në Shekuj" (Ribotim), Toena, Tiranë, 2006, f. 266; Petro Marko, *Intervistë me vetveten*, OMSCA, 2000, Tiranë, f. 47; Rami Memushaj, *Patronimet e Himarës*, në "Himara në shekuj" (Ribotim), Toena, Tiranë, 2006, f. 309.

<sup>6</sup> *Fjolor enciklopedik shqiptar*, Kristalina-KH, 2008, Tiranë, f. 1422.

së brendshme të Labërisë janë trajtuar gjerësisht edhe nga studiuesi R. Memushaj<sup>7</sup>. Edhe sipas hulumtimeve tona, një dëshmi e qartë që tregon lidhjet shumëvjeçare dhe historike të këtyre krahinave është fakti se shumë fise të Gumenicës e kanë prejardhjen nga Bregu i Detit, nga zona e Himarës. Kështu, mëhalla *Mehmetosmënaj*, e krijuar nga dy vëllezërit, Mehmeti dhe Osmëni, e ka prejardhjen nga Dhërmiu. Origjinën e tyre të hershme e kanë nga Gjini Leka, i ardhur nga Kruja. Qindra vjet më parë, pas vdekjes së Skënderbeut, janë vendosur në Dhërmi, në vendin e quajtur *Gjilek*. Për arsye vetëmbrojtjeje janë larguar nga Dhërmiu dhe, si vend më të përshtatshëm e strategjik, kanë gjetur Gumenicën. Degëzime të kësaj mëhalle janë fiset: Osmënaj, Demiraj, Demaj, Xhaferaj, Skëndaj, Sinanaj, Hallullaj, Hodaj, Zykaj, Kamberaj, Brahimaj, Kananaj, Lutaj, Mehmetaj etj. Gjithashtu nga Himara e kanë prejardhjen edhe fise të tjera të Gumenicës, si: Ruçajt (sot Ismailaj), që kanë ardhur nga Ruçajt e Himarës, Begëvarfajt (Begajt, Beqirajt), Lelajt, Skëndomuçajt, Mustafarajt, Veshajt, Merkove-shajt etj. Të gjitha këto lëvizje të ndërsjella dhe lidhjet e ngushta shumëvjeçare kanë ndikuar natyrshëm edhe në veçoritë etnografike, kulturore e gjuhësore të këtyre krahinave. Shumë rite, mite dhe besime popullore në të folmen e Gumenicës janë të njëjta e të përafërta me ato të Bregut të Sipërm. Studiuesi M. Tirta<sup>8</sup>, i cili ka trajtuar mitet dhe besimet në Bregdetin e Sipërm të Himarës, arrin në përfundimin se dukuritë mitologjike të kësaj popullsie [të Bregdetit të Sipërm], që është e besimit të krishterë, janë të përbashkëta me Labërinë, që është e besimit mysliman. Në këtë trajtesë synojmë të paraqesim veçoritë e përbashkëta gjuhësore të këtyre të folmeve, kryesisht në rrafshin fonetik dhe morfologjik.

E folmja e Gumenicës dhe e folmja e Himarës bëjnë pjesë në toskërishten jugore, në nëngrupin e labërishtes si grupime të mëdha, ndërsa si njësi gjuhësore më të vogla, e folmja e Gumenicës me gjithë fshatrat e tjerë të njësisë administrative Kotë<sup>9</sup> dhe e folmja e Himarës përbëjnë areale gjuhësore më vete.

<sup>7</sup> Rami Memushaj, *Himara në dritën e të dhënave historike, gjuhësore dhe etnologjike*, Toena, Tiranë, 2004, f. 91-116.

<sup>8</sup> Mark Tirta, *Mite dhe besime në Bregdetin e Sipërm të Himarës*, në “Himara në shekuj” (Ribotim), Toena, Tiranë, 2006, f. 270.

<sup>9</sup> Fshati *Kotë* (si fshat më i ri) nuk mund të përfshihet në këtë areal dialektor, sepse ka popullsi të përzier nga gjithë krahina e Lumit të Vlorës. (shih më hollësisht A. Xhaferaj, *Vështrim gjuhësor mbi të folmen e Gumenicës*, Julvin, Tiranë, 2015, f. 278). Origjina e emërvendit *Kotë* vjen prej italishtes *quota* “lartësi”. Në dhjetor 1914 Italia pushtoi krahinën e Vlorës dhe vendosi në shumë zona garnizone ushtarake. Në pjesën e sipërme

## Tipare të përbashkëta të së folmes së Gumenicës me të folmet e Bregut të Detit në rrafshin fonetik

Ndër tiparet e përbashkëta të këtyre të folmeve në rrafshin fonetik mund të përmendim:

1. Shndërrimi i zanoreve të theksuara *a* dhe *e* në *ë* para tingujve hundorë *m*, *n* e *nj*: *fëmër*, *mëndja*, *i patrëmbur*, *gjëndje*, *gështënjë*, *e ënjte*, *qën*, *mën*, *dhën*, *mëngët* (<mangut), *dëm* etj. Kjo veçori është e përbashkët në të gjitha të folmet e toskërishtes jugore<sup>10</sup>, por, në të folmen e Gumenicës dhe të Himarës, tek brezi i vjetër, ndërrimi i *e*-së në *ë* ndeshet edhe në disa fjalë të tjera, kryesisht para bashkëtingëllores dridhëse *r* dhe glotales *h*, si: *njërs* (<njerëz), *strëha* (<streha), *prëhem* (<prëhem) etj.

2. Prania e kundërvënies midis zanoreve të shkurtra dhe zanoreve të gjata. Në të folmen e Gumenicës zanoret e gjata të theksuara ndeshen kryesisht në rrokje të hapura fundore: *bé:*, *ngé:*, *rrufé:*, *kallamé:*, *qesé:*, *midé:*, *goné:*, *çudí:*, *folé:*, *hatá:*, *drú:*, *hú:* etj., megjithatë, ato janë shumë të rralla edhe tek brezi i vjetër, ndryshe nga e folmja e Himarës, ku gjatësia ruhet mjaft mirë.

3. Shkrirja e grupeve të zanoreve *ae* dhe *ee* në *e* gjatë zgjedhimit të foljeve dhe gjatë lakimit të emrave: *vre:* (vrae), *pre:* (preje), *i Gjone* (i Gjonajve). Madje, në këtë rast këto zanore ndihen si më të gjata<sup>11</sup>. Dukuria e shkrirjes vepron edhe në sintagmat emërore të tipit *emër+emër* në gjinore, *emër+mbiemër* dhe *emër+përemër*: *vajze vëllait*, *vajze madhe*, *djali math*, *djali saj* etj.

4. Shndërrimi i *ë*-së në *u*. Një *ë* e patheksuar edhe në të folmen e Gumenicës, ashtu si në të folmen e Kurveleshit<sup>12</sup>, të Bregdetit të Poshtëm, të Bregdetit të Sipërm<sup>13</sup>, të Gjirokastrës dhe Çamërisë<sup>14</sup> në disa raste ka

---

të territorit të sotëm të fshatit *Kotë* ka qenë *Quota* [kuota] 115, në të cilën ishte spitali dhe rezidenca e gjeneralit Gotti (shih me hollësisht edhe B. Dervishaj, *Lavdi e vulosur me gjak*. Lufta e Vlorës e vitit 1920, Tiranë, 2004, f. 53.).

<sup>10</sup> Natasha Sotiri, *E folmja e Himarës*, në "Himara në Shekuj", Toena, Tiranë, 2006, f. 270.

<sup>11</sup> Po aty, f. 271; Rami Memushaj, *Himara në dritën e të dhënave historike, gjuhësore dhe etnologjike*, Toena, Tiranë, 2004, f. 177.

<sup>12</sup> Menella Totoni, *Vëzhgime rreth të folmeve të Kurveleshit*, në DSh, I, Tiranë, 1971, f. 45.

<sup>13</sup> Rami Memushaj dhe Helena Grillo, *Vendi i së folmes së Himarës në dialektin jugor të shqipës*, në SF, 1-2, Tiranë, 2009.

<sup>14</sup> Jorgji Gjinari dhe Gjovalin Shkurtaj, *Dialektologjia*, Tiranë, 2003, f. 191.

dhënë *u*: *kushuri* (<kushëri), *ulurij* (<ulërij), *cinxur* (<cinxër), *mushtjerrë* (<mështjerrë), *kulish* (<këlysh), *pullump* (<pëllumb).

Sistemi bashkëtingëllor i këtyre të folmeve ka 29 fonema dhe paraqet pika takimi me të folmet e tjera të toskërishtes jugore. Kështu, ndër tiparet e përbashkëta të këtyre të folmeve në këtë sistem fonemash bashkëtingëllore mund të përmendim:

1. Afrikatizimi i bashkëtingëlloreve shtegore, në ndonjë rast edhe i qiellzores *q*:

*s* > *c*: *ckifer* (<skifer), *cfurk* (<sfurk), *cmirë* (<smirë), *kurcej* (<kur-sej);

*z* > *x*: *xbres* (<zbres), *xbuloj* (<zbuloj), *xbut* (<zbut), *benxinë* (<benzinë);

*sh* > *ç*: *çkul* (<shkul), edhe në fund të fjalës: *do viç* (< do të vish);

*zh* > *xh*: *xhvilloj* (<zhvilloj), *xhduk* (<zhduk), *xhesh* (<zhvesh);

*q* > *ç*: *lakuriç* (<lakuriq), *kariç* (<karriq).

2. Sonorizimi i bashkëtingëlloreve të shurdhëta, kryesisht midis zanoreve ose para bashkëtingëlloreve të zëshme:

*k* > *g*: *gërdisi* (<kërdisi), *godosh* (<kodosh), *portogalle* (<portokalle);

*s* > *z*: *azgjë* (<asgjë), *mezditë* (<mesditë), *z'gjëj* (<s'gjej), *z'dua* (<s'dua);

*sh* > *zh*: *zhaptore* (<shaptore);

*t* > *d*: *gode* (<gotë), *digan* (<tigan);

*ç* > *xh* ose *zh*: *xhdo* ose *zhdo* (<çdo).

3. Qiellzorëzimi i prapagjuhores *k* në *q* përpara zanoreve *i*, *y*, *e* dhe *a*, si dhe shndërrimet e grupeve të mëposhtme të bashkëtingëlloreve:

*k* > *q*: *qishë* (<kishë), *qillo* (<kile), *maqinë* (<makinë);

*sq* > *cj*: *çjep* (<sqep), *çjepar* (<sqepar), *çjaroj* (<sqaroj), *çjufur* (<squfur);

*shq* > *çj*: *çjep* (<shqep), *çjuaj* (<shquaj “dalloj”);

*shq* > *ç*: *çit* (<shqit), *çyej* (<shqyej);

*zgj* > *xj*: *xjua* (<zgjua), *xjedhje* (<zgjedhje), por grupi *zgj* > *x* te *xith* (<zgjidh).

4. Ruajtja e grupeve të bashkëtingëlloreve /mb/, /nd/, /ng/: *mbaroj*, *mbuloj*, *brumbull*, *këmbej*, *nder*, *hundë*, *këndo*, *i ngushtë*, *ngarkoj*, *cingo* etj. Në këtë pikë e folmja e Gumenicës afrohet me të folmen e Himarës e të

Qeparoit<sup>15</sup>, ndërsa e folmja e Bregdetit të Poshtëm nuk paraqitet unike lidhur me zhvillimin fonetik të këtyre grupeve.<sup>16</sup>

5. Dukuria e rotacizmit, e përfutur në dialektin jugor, në këto të folme ndeshet edhe në urdhëroren shumë të disa foljeve: *fliri* (flini). *Bini* e *fliri!*<sup>17</sup> Madje në krahinën e Himarës kjo dukuri është më e theksuar: *Ç'keni këmbana që s' biri/ apo u ka mbyll Veziri?/ Biri, moj të shkreta biri, /Vasil Kriston të ma ziri,/ gjallë a dekur të ma biri* ose *Dili kollogrinja dili,/ si u zë gjumi e fliri,/ po na rrethoset Vasili.*<sup>18</sup>

6. Gjithashu, dukuritë fonetike, si: *asimilimi, disimilimi, metateza, shesat dhe rëniet e tingujve* etj., që shfaqen në ligjërimin bisedor të brezit të vjetër e të mesëm, e afrojnë të folmen e Gumenicës me të folmet e tjera të Bregdetit të Sipërm dhe të Poshtëm.<sup>19</sup>

### Tipare të përbashkëta në rrafshin morfologjik

Nga mbledhja, përzgjedhja dhe krahasimi i veçorive gjuhësore të këtyre të folmeve, ndër tiparet e përbashkëta në fushën e morfologjisë mund të përmendim:

1. Ruajtja e gjinisë asnjëse te disa emra konkretë, kryesisht lënde, si: *dhjamë, mish, lesh, vaj, ujë* etj., tek brezi i vjetër, e pjesërisht tek brezi i mesëm. Në të folmen e Gumenicës, te brezi i ri, emra të tillë dalin në gjini në mashkullorë, ashtu si në të folmet e tjera të Labërisë. Në këtë rast, në të folmen e Gumenicës, ashtu si në të folmen e Kurveleshit, në të folmen e Qeparoit dhe të Bregdetit të Poshtëm kemi të bëjmë me inovacion. E folmja e Himarës dhe çamërishtja paraqiten më konservative.

2. Përdorimi si emra femërorë i disa emrave jofrymorë, të cilët në shqipen e sotme përdoren si mashkullorë: *litare-litarja, fustane-fustania, turpe-turpja, faje-faja* etj. Emra të tillë përdoren si femërorë përgjithësisht

<sup>15</sup> Natasha Sotiri, *E folmja dhe toponimia e Qeparoit*, Konica, 2001, Tiranë, f. 31; Shih edhe Natasha Sotiri, *E folmja e Himarës...*, f. 272; Rami Memushaj dhe Helena Grillo, *Vendi i së folmes së Himarës...*, f. 36.

<sup>16</sup> Menella Totoni, *E folmja e Bregdetit të Poshtëm*, në SF, 1, Tiranë, 1964, f. 141.

<sup>17</sup> Artan Xhaferaj, *Vështrim gjuhësor mbi të folmen e Gumenicës*, Julvin, Tiranë, 2015, f. 124.

<sup>18</sup> Fane Veizi, *Bregu i Detit në ...*, f. 423; shih edhe Natasha Sotiri, *E folmja dhe toponimia e ...*, f. 32.

<sup>19</sup> Artan Xhaferaj, *Vështrim gjuhësor...*, f. 53-59; Menella Totoni, *E folmja e Bregdetit...*, f. 142-145; Natasha Sotiri, *E folmja dhe toponimia e ...*, f. 32-35; Rami Memushaj dhe Helena Grillo, *Vendi i së folmes së Himarës...*, f. 36-38.

në ligjërimin e brezit të vjetër e të mesëm në të folmen e Gumenicës dhe në të folmen e Bregdetit të Sipërm, por edhe në të folmen e Bregdetit të Poshtëm.

3. Mungesa e tingullit kundërhiatizues [-j-] para nyjës së prapme *-a* tek emrat femërorë që dalin me zanoren e theksuar *-i*, si: *bukuri-bukuria*, *liri-liria*, *shtëpi-shtëpia*, *kusi-kusia* etj. Një dukuri e tillë shfaqet në të folmen së Gumenicës, në të folmen e Bregdetit të Poshtëm, në të folmen e Qeparoit dhe në shqipen standarde.

4. Shndërrimi i *o*-së në *ua* në trajtën e shquar tek emrat mashkullore dhe femërorë me theks parafundor, të përgjithshëm ose të përveçëm, që dalin me *-o* të patheksuar, si: *Lesko-Leskua*, *Vito-Vitua*, *dajo-dajua*, *pakopakua*, *pallto-palltua*. Ndryshe nga shqipja standarde, në këtë pikë e folmja e Gumenicës afrohet me të folmen e Qeparoit.

5. Formimi i trajtës së rasave të zhdrejta, të disa emrave të gjinisë mashkullore, por edhe femërore, me mbaresën *-e* në shumës: *vëllezre* (ll vëllezërve), *qëne* (ll qënve), *miqe* (ll miqve), *djeme* (ll djemve), *dhëne* (ll dhënve), *pleqe* (ll pleqve). Një dukuri e tillë shfaqet shpesh në të folmen e Gumenicës dhe në të folmen e Bregdetit të Poshtëm e të Sipërm. Por karakteristike për të folmen e Himarës është edhe ruajtja e mbaresë nyjës *-t* në shumësin e shquar: *miqet*, *pleqet* etj., gjë që përbën një tipar konservativ të saj.<sup>20</sup>

6. Përdorimi i nyjësuar i emrave patronimikë, si dhe i emrave që tregojnë banorin e një vendi, si: *i Çunaj*, *i Veshaj*, *i Xhaferaj*, *i gumenicjot*, *i mazharjot* etj. Një dukuri e tillë haset shpesh në të folmen e Gumenicës dhe, sipas M. Totonit<sup>21</sup>, ndodh edhe në të folmen e Bregdetit të Poshtëm: *i Spiraj*, *i Xhanaj*, *i delvinjot*, *i piqeras* etj. Në të folmen e fshatrave të Bregut të Sipërm emrat patronimikë, si: *i Koçe*, *e Dhimet* gjithashtu përdoren të nyjësuar<sup>22</sup>, ndërsa emrat që tregojnë banorin e një vendi, përgjithësisht përdoren pa nyjë: *dhërmias*, *piluriot*, *palasikot* etj.

7. Përdorimi i nyjës së përparme *e* në vend të nyjës së përparme të ose së, p.sh.: *në bisht të Udhës e Madhe*, *në krye të Dërrasës e Gjatë*, *vajza e djalit e Sadikut*, *afër Bregut e Pramatës*, *në mes të Fushës e Përtejlumes*, *i thash' djalit e vogël*, *shkova anës e gardhit*, *njeriut e lik dëftoi vëndin* etj.<sup>23</sup>;

<sup>20</sup> Rami Memushaj dhe Helena Grillo, *Vendi i së folmes së Himarës...*, f. 39-40.

<sup>21</sup> Menella Totoni, *E folmja e Bregdetit...*, f. 148.

<sup>22</sup> Rami Memushaj dhe Helena Grillo, *Vendi i së folmes së Himarës...*, f. 41.

<sup>23</sup> Artan Xhaferaj, *Vështrim gjuhësor...*, f. 83.

*një pelë e grivës e malit*<sup>24</sup>; *O Sofia, o uratë, / jeshe bijë Pagnarat, / të ma kesh jetën e gjatë*.<sup>25</sup> Një dukuri e tillë ndeshet në të folmen e Gumenicës, në të folmet e Bregdetit të Poshtëm, të Qeparoit e Vunoit, por edhe në të folmet e Kurveleshit e Çamërisë.

8. Ruajtja e mbaresës *-te* në vetën e parë njëjës në mënyrën dëftore të foljeve *kam* dhe *jam*: *kam-teljam-te*. Unë ëmrin e ***kamte*** K. B. ***Kamte*** *shkollën e mesme natën*<sup>26</sup>; *Djalë mos të vijë rëndë, / se jam njerë e s'jamte nënë*<sup>27</sup>; ***Kamte*** *hall për vilajet*<sup>28</sup>. ***Jamte*** *mbushur vrer e gjëmë*<sup>29</sup>. Gjithashtu, në të folmen e Gumenicës dhe në të folmet e Bregdetit të Sipërm dhe të Poshtëm hasen shpesh edhe format arkaike të së pakryerës së foljeve ndihmëse *kam* dhe *jam*. ***Jeshje*** *trim për në sinuar, / jo me dyfek, po me duar*<sup>30</sup>. ***S'keshe*** *parë plumb kauri, / që të shpon si alë gruri*<sup>31</sup>.

9. Mbaresa e vetës së tretë njëjës *-j*, në të pakryerën, që shfaqet edhe në disa folje me temë në zanore, si *vij*, *dua* etj., e afron të folmen e Gumenicës me të folmen e Bregdetit të Sipërm e të Poshtëm (edhe me të folmen e Kurveleshit, të Çamërisë dhe të arbëreshëve të Italisë.) P. sh.: ***Ai vij*** (vinte) *nga Vlora. Miku duaj* (donte) *të më mban për darket*.<sup>32</sup>; *Ç'u tërbua arap i zi, / nga llahtara tym i zi, / s'i vij në ndihmë njeri; Qaj, o Çikë, me Gjlinikë, / se dreri juaj ka ik, / që i vij botës frikë, / dhe nuk na qasej e ligë*.<sup>33</sup>

10. Ruajtja e formave të vjetra sigmatike në vetën e parë njëjës të së kryerës së thjeshtë *qeç* (ll qe-sh-ë), *paç* (ll pat-sh-ë), *gjeç* (ll gjet-sh-ë) e *arç* (ll ardh-sh-ë). P.sh.: ***Qeç*** *me dhën në mal. Paç* (pata) *një kal' të mirë*.<sup>34</sup>; *thash sa paç takan*<sup>35</sup>. Forma të tilla ndeshen në të folmen e Gumenicës dhe në të folmet e Bregdetit të Poshtëm dhe të Sipërm.

11. Ruajtja e formave të hershme të së kryerës së thjeshtë në vetat e shumësit te disa folje apofonike me temë me bashkëtingëllore *l*, *ll*, *r* e *rr*, të

<sup>24</sup> Kozma Nushi, *Këngë popullore të krahinës së Himarës dhe të Labërisë*, Toena, Tiranë, 2014, f. 156.

<sup>25</sup> Fane Veizi, *Bregu i Detit në ...*, f. 15.

<sup>26</sup> Artan Xhaferaj, *Vështrim gjuhësor...*, f. 263.

<sup>27</sup> *Po aty*, f. 254.

<sup>28</sup> Fane Veizi, *Bregu i Detit në ...*, f. 163.

<sup>29</sup> *Po aty*, f. 114.

<sup>30</sup> Artan Xhaferaj, *Vështrim gjuhësor...*, f. 106-107.

<sup>31</sup> Fane Veizi, *Bregu i Detit në ...*, f. 212.

<sup>32</sup> Artan Xhaferaj, *Vështrim gjuhësor...*, f. 109.

<sup>33</sup> Fane Veizi, *Bregu i Detit në ...*, f. 104, 373.

<sup>34</sup> Artan Xhaferaj, *Vështrim gjuhësor...*, f. 112.

<sup>35</sup> Menella Totoni, *E folmja e Bregdetit...*, f. 153.

cilat dalin me temë me grupin zanor *ua*: *duallm* (dolëm), *duallt* (dolët), *dualln'* (dolën); *nxuarrm* (nxorëm), *nxuarrt* (nxorët), *nxuarrn'* (nxorën) etj. *Vanë djelt' e Vunoit vanë, / iknë e muar dunjanë; Qeparotë në Himarë, / muar gjemit' e vanë*<sup>36</sup>; Forma të tilla ndeshen në të folmen e Gumenicës<sup>37</sup> dhe në të folmet e Bregdetit të Poshtëm<sup>38</sup> dhe të Sipërm<sup>39</sup>.

12. Mbaresat vetore të kohës së tashme dhe të kohës së pakryer të dëftores në format foljore të zgjedhimit jovepror: *-nem/-nështa* (-hem/-hështa), *-nesh/-nështa* (-hesh/-hështa), *-net/-nësh*, *-nej* (-het/-hej,-ej), *-nemi/-nëshim* (-hemi/-hëshim), *-neni/-nëshit* (-hëni/-hëshit), *-nen/-nëshin* (-hën/-hëshin). P. sh. *kthenem* (kthehem), *martonej* (martohej), *përvëlonej* (përvëlohej): *Nashti po kthenem nga daveta. Atë ditë martonej djali. Po përvëlonej nga temperatura.*

13. Gjithashtu, strukturat e formave foljore të së ardhmes me *do* (do punoj, do dal); format e përcjellores me pjesëzën *tuke* (tuke kënduar) si dhe pjesëza *njëra* (deri): *njëra nesër*, “e cila është përfutur nga trajta më e vjetër *ngjer* si rrjedhim i asimilimit *ngj > nj* dhe shtimit të një *a*-je epitetike”<sup>40</sup>, janë dukuri të përbashkëta të këtyre të folmeve.

Ngjashmëri midis këtyre të folmeve vërehen edhe në fushën e onomastikës<sup>41</sup>. Sipas prof. Shaban Demiraj<sup>42</sup>, emrat e krishterë më të hershëm: *Gjon, Gjokë, Gjin, Gjikë* dhe *Pal* janë emrat më të përdorur në të gjitha trevat e banuara nga shqiptarët. Trajta shqipe *Gjon* është e përhapur si në veri e në jug, si ndër katolikë dhe ndër ortodoksë. Ky emër dëshkohet edhe për vendbanimet në Himarë, në Dhërmi, në Palasë e Qeparo. Edhe në Defterin e regjistrimit osman të Sanxhakut të Vlorës (1583), në fshatin Gumenicë, emri *Gjon* dëshkohet në 8 raste si emër personi dhe si mbiemër ndër 141 burra kryefamiljarë dhe 20 djem beqarë (*Gjon Martini, Gjon Jorgo, Gjon Jano, Strati Gjoni, Mihal Gjon Neshi, Vasil Gjoni* etj.), varianti *Gjin* dëshkohet në 9 raste (*Vasil Gjini, Dhimo Gjini, Petko Gjini, Gjini Marku, Gjin Drugari* etj.), emri *Gjikë* del 4 herë (*Gjik Gjergji, Gjika Jorgo, Kond*

<sup>36</sup>Fane Veizi, *Bregu i Detit në ...*, f. 161, 169.

<sup>37</sup>Artan Xhaferaj, *Vështrim gjuhësor...*, f. 111.

<sup>38</sup>Menella Totoni, *E folmja e Bregdetit...*, f. 152.

<sup>39</sup>Natasha Sotiri, *E folmja dhe toponimia e ...*, f. 79; Rami Memushaj dhe Helena Grillo, *Vendi i së folmes së Himarës...*, f. 44.

<sup>40</sup>Rami Memushaj dhe Helena Grillo, *Vendi i së folmes së Himarës...*, f. 48.

<sup>41</sup>Shih edhe Rami Memushaj, *Patronimet e Himarës*, në “Himara në shekuj” (Ribotim), Toena, Tiranë, 2006, f. 293-317.

<sup>42</sup>Shaban Demiraj, *Gjuha amtare në Bregdetin Jugor shqiptar gjatë shekujve*, në “Himara në shekuj” (Ribotim), Toena, Tiranë, 2006, f. 249-250.

*Gjika* etj.), ndërsa emri *Gjokë* del një herë (Jani *Gjoka*). “Trajta greke *Jani*,... në ndikimin e kishës greke është përhapur shumë ndër ortodoksët e Shqipërisë jugore në trajtën *Jani*, sidomos gjatë shekujve të fundit, duke zëvendësuar trajtën më të vjetër vendëse *Gjon*. Një zëvendësim i tillë bie në sy për Beratit qysh në regjistrimin osman të vitit 1520, ku jo vetëm trajta *Gjon*, por dhe varianti *Gjin* ndeshen relativisht mjaft më pak se trajta *Jani*.”<sup>43</sup> Kjo gjë dëshmohet edhe për Gumenicën, sipas të dhënave të të njëjtit Defter, ku trajta greke *Jani* del më shpesh (25 raste), si emër personi dhe mbiemër (p. sh. *Jani Gjoka*, *Jani Galo*, *Jani Gogo*, *Nikolla Jani*, *Brati Jani*, *Mihal Jani* etj.), ndërsa emrat vetjakë *Gjon*, *Gjin*, *Gjikë* e *Pal* ndeshen më pak.

Dukuritë e përbashkëta që vihen re në këmbimet a shndërrimet e fonemave, në disa forma të përbashkëta gramatikore në gjini e rasë, në përdorimin a shkrirjen e nyjave, tek mbaresat vetore apo në përbërjen fonemore të disa temave foljore dëshmojnë qartë se këto fjalëforma kanë qenë në përdorim të pandërprerë nga stërgjyshërit e shqiptarëve qysh prej kohësh të hershme.

Si përfundim, nga sa u shtjellua edhe në këtë punim, siç është shprehur edhe profesor Shaban Demiraj<sup>44</sup>, për sa i takon gjuhës amtare, shqipes, e folmja e bregdetit jugor nuk mund të veçohet nga të folmet e tjera të dialektit jugor të gjuhës shqipe dhe, ashtu si këto, i është nënshtruar një evolucioni të pandërprerë qysh nga kohët e lashta. E ky evolucion i gjatë me karakter dialektor dhe nëndialektor parakupton një prani të pandërprerë të elementit të vjetër autokton, i cili, me gjithë trysnitë e shumta, sidomos gjatë pushtimit romak, ka mundur ta ruajë identitetin e vet etnik, ashtu si etnosi arbëresh në përgjithësi.

---

<sup>43</sup> *Po aty*, f. 250.

<sup>44</sup> *Po aty*, f. 261.

**Literatura:**

Alexoudes, A. (1868). *Σψντομοσ ιστορικε περιγραππε τεσλερασ μητροπολεοσ Βελεγραδον...*; [Përshkrim i shkurtër historik i metropolisë së Beratit dhe i vendeve që janë nën vartësinë e saj shpirtërore], Kerkyra, përkthyer nga V. Nika.

Demiraj, Sh. (2006). *Gjuha amtare në Bregdetin Jugor shqiptar gjatë shekujve*, në “Himara në shekuj”, Toena, Tiranë. (Ribotim).

*Fjolor enciklopedik shqiptar*, (2008). Kristalina-KH, Tiranë.

Gjinari, J. dhe Shkurtaç, Gj. (2003). *Dialektologjia*, Tiranë.

Kabo, M. (2006). *Veçori gjeografike të trevës së Himarës*, në “Himara në shekuj”, Toena, Tiranë. (Ribotim).

Marko, P. (2000). *Intervistë me vetveten*, OMSCA, Tiranë.

Memushaj, R. (2004). *Himara në dritën e të dhënave historike, gjuhësore dhe etnologjike*, Toena, Tiranë.

Memushaj, R; Grillo, H. (2009). *Vendi i së folmes së Himarës në dialektin jugor të shqipes*, në SF, 1-2, Tiranë.

Memushaj, R. (2006). *Patronimet e Himarës*, në “Himara në shekuj”, Toena, Tiranë. (Ribotim).

Nushi, K. (2014). *Këngë popullore të krahinës së Himarës dhe të të Labërisë*, Toena, Tiranë.

Rrapaj, F. M. (1991). *Këngë popullore të Labërisë*, Tiranë.

Sinani, Sh. (2006). *Himara: identiteti i bashkësisë dhe etnotipi*, në “Himara në Shekuj”, Toena, Tiranë. (Ribotim).

Sotiri, N. (2001). *E folmja dhe toponimia e Qeparoit*, Konica, Tiranë.

Sotiri, N. (2006). *E folmja e Himarës*, në “Himara në Shekuj”, Toena, Tiranë. (Ribotim).

Tirta, M. (2006). *Mite dhe besime në Bregdetin e Sipërm të Himarës në “Himara në shekuj”*, Toena, Tiranë. (Ribotim).

Totoni, M. (1964). *E folmja e Bregdetit të Poshtëm*, në SF, 1, Tiranë.

Totoni, M. (1971). *Vëzhgime rreth të folmeve të Kurveleshit*, në DSh, I, Tiranë.

Veizi, F. (1998). *Bregu i Detit në këngë*, Arbri, Tiranë.

Xhaferaj, A. (2015). *Vështrim gjuhësor mbi të folmen e Gumenicës*, Julvin, Tiranë.

**LINGUISTIC APPROACHES BETWEEN  
THE GUMENICA'S VERNACULAR DIALECT OF  
VLORA AND THE SPEECHES OF *BREGU I DETIT***

**Summary**

In this paper we will discuss some linguistic approaches between the Gumenica's vernacular dialect of Vlora district and the dialects of *Bregu i Detit*. This paper aims to recognize commonalities and differences between these vernacular dialects, comparing them with standard Albanian. The rites, myths, beliefs and common linguistic features of these dialects are closely related to the common history of the provinces. The attention is focused on the common features of the phonetic and morphological system. Great similarity between these dialects is clearly evidenced by facts and linguistic phenomena which are explained according to the rules of the evolution of phonetic system and morphological structure of Albanian. The methodology of this study includes analysis and comparison. To conclude this paper, we have been based on our study of Gumenica's vernacular dialect and on other Albanian scholars' researches about the speeches of *Bregu i Detit*.

